



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of Minister of Justice

Nr. 308 /2025

Datë: 11/06 /2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 6 (paragrafi 8) të Ligjit nr. 08/L-272 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe në bazë të kërkesës së datës 10.06.2025, Zëvendësministri në detyrë i Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e znj. Kaltrina Hysenaj - Fetahaj, e emëruar notere në juridiksionin territorial të Komunës së Leposaviqit për zgjatjen e afatit për fillimin e ushtrimit të detyrës së noterit edhe për 30 ditë, përkatësisht deri me datë 09/07/2025.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. Kaltrina Hysenaj - Fetahaj e emëruar notere në juridiksionin territorial të Komunës së Leposaviqit me Vendimin nr. 171/2024, të datës 15.07.2024, ka parashtruar kërkesë për zgjatjen e afatit për fillimin e ushtrimit të detyrës së noterit, për shkak të problemeve shëndetësore sipas dëshmisë mjekësore nr. 2555, të datës 29.04.2025.

Me vendimin nr. 253/2025 të datës 06.05.2025 është aprovuar kërkesa për zgjatjen e afatit për fillimin e ushtrimit të detyrës së noterit deri me datë 20.05.2025.

Me datë 21.05.2025 përmes formës elektronike - email, znj. Kaltrina Hysenaj - Fetahaj ka dërguar raportim mjekësor me numër të protokollit 600/2025 të datës 21.05.2025 për vazhdimin e pushimit mjekësor edhe për 2 javë.

Me datë 10.06.2025 përmes formës elektronike - email, znj. Kaltrina Hysenaj - Fetahaj ka paraqitur kërkesën për zgjatjen e afatit për fillimin e ushtrimit të detyrës së noterit edhe

për 30 ditë, kërkesës ia ka bashkëngjitur raportin mjekësor me numër 3422 të datës 09.06.2025.

Duke vepruar në bazë të kërkesës së palës dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Blerim SALLAHU
Zëvendësministër në detyrë i Drejtësisë



Vendimi i'u dërgohet:

- Znj. Kaltrina Hysenaj - Fetahaj;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Odës së Noterëve të Kosovës;
- Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.